

NJË GRUSHT DASHURI

Berzat Sadiki

Boton:
Shoqata e shkrimtarëve PRO LITERA
Rr. 167, nr. 6, Tetovë 1200
Republika e Maqedonisë së Veriut
shoqatapro-litera@gmail.com

Redaktor: Berzat Sadiki

Lektura, recensionin dhe përpunimi grafik:
PRO LITERA

Shtypi: Art grafik, Tetovë

Tirazhi: 500 kopje

Berzat Sadiki

**NJË GRUSHT
DASHURI
POEZI**

Pro litera, 2026 - Tetovë

KUSHTIM

Këtë grusht dashurie
ua kushtoj njerëzve
që japin pak nga vetja
dhe shumë nga zemra.

Berzat Sadiki

PARATHËNIE

Ka libra që lindin nga idetë, ka libra që lindin nga ngjarjet, ndërsa ka edhe libra që vijnë ngadalë, si afrim i brendshëm i njeriut me vetveten dhe me tjetrin.

“Një grusht dashuri” i përket kësaj të fundit.

Këto poezi nuk kërkojnë të shpallin të vërteta të mëdha, as të ngrihen mbi lexuesin me mendime që kërkojnë bindje, ato afrohen ndryshe: me derë të hapur, me karrige pranë tryezës, me dorë që zgjatet, me filxhan që pret, me kujtim që nuk është larguar, edhe kur njeriu që e ka krijuar atë kujtim nuk është më.

Në shumë prej këtyre poezive jeta shfaqet pikërisht aty ku shpesh nuk e vërejmë: në përshëndetje të zakonshme, në pritjen e dikujt, në fjalë të thënë me kohë, në fotografi të vjetër, në heshtjen e dy njerëzve që kuptohen pa folur.

Njeriu gjatë jetës kërkon shumë. Kërkon të kuptohet, të pranohet, të kujtohet, ta ketë dikë pranë, por ajo që i duhet më së shumti mund të jetë shumë më e thjeshtë: pak mirësi, pak kujdes, dorë mbi sup, fjalë të ngrohtë - një grusht dashuri.

Jo dashuria si fjalë e madhe.

Dashuria si prani.

Si bukë e ndarë.

Si derë e lënë hapur.

Si pritje.

Si falje.

Si heshtje pranë dikujt që ka nevojë të mos jetë i vetmuar.

Prandaj nëpër këto faqe ka nëna, baballarë, fëmijë, miq, të moshuar, të panjohur, shtëpi, rrugë, shi, dritare, bukë, duar dhe shumë heshtje.

Jeta e njeriut nuk përbëhet vetëm nga ngjarjet e mëdha, ajo ndërtohet nga ato çaste të vogla që, vetëm kur kalojnë, i kuptojmë se kanë qenë vetë jeta.

Dhe ndoshta njeriu nuk ka nevojë ta mbajë gjithë botën në duar, ndonjëherë mjafton të ketë çfarë t'i japë tjetrit:

një grusht dashuri.

HYRJE

Poezia është nga mënyrat më të hershme me të cilat njeriu është përpjekur të mos e lërë përjetimin të humbasë.

Fjala poetike nuk e ndalon kohën, por mund ta mbajë një çast të gjallë. Ajo nuk e kthen njeriun e larguar por mund ta sjellë pranë nëpërmes kujtesës. Nuk e zhduk dhimbjen, por ndonjëherë i jep asaj vend ku mund të pushojë.

Përmbledhja “Një grusht dashuri” ndërtohet mbi marrëdhënien ndërmjet njeriut, fjalës dhe nevojës së tij për afërsi.

Në qendër të saj është njeriu i zakonshëm. Jo njeriu si ide abstrakte, por ai që jeton, pret, dashuron, gabon, fal, plaket, humb dhe kujton. Ai që kthehet në shtëpi. Ai që gjen vend për prehje. Ai që hap fotografi të vjetër. Ai që dëgjon përsëri këngë të rinisë. Ai që e mban dorën e babait pasi dikur babai ia kishte mbajtur dorën atij.

Në këtë zgjedhje poetike shihet edhe një lëvizje e brendshme e autorit.

Berzat Sadiki ka hyrë në letërsi nëpërmes një marrëdhënieje të gjatë me fjalën, mendimin dhe kërkimin

e kuptimit. Fryma e tij krijuese ka kaluar nëpër shtresa të ndryshme: nga poezia dhe refleksioni letrar, te mendimi filozofik, te pyetjet ontologjike dhe te kërkimi për marrëdhënien mes njeriut, dijes dhe Burimit të saj.

Kjo përvojë nuk largohet nga përmbledhja, ajo vetëm e ndryshon mënyrën e pranisë.

Këtu nuk del në plan të parë si sistem, por si thellësi e heshtur.

Autori nuk kërkon më domosdoshmërisht ta çojë lexuesin te një përfundim. Ai përpiket të krijojë një çast ku lexuesi të mund të arrijë vetë te përfundimi i tij. Kjo është edhe fryma e këtij libri.

Nga deklarimi te përjetimi.

Nga mendimi i dhënë te mendimi i lindur.

Nga fjala që udhëzon te fjala që afron.

Nga dashuria si nocion te dashuria si gjest.

Në këtë kuptim, objektet e zakonshme marrin funksion të veçantë poetik. Buka nuk është vetëm ushqim, por ndarje dhe afërsi. Dera është pritje. Dritarja është mundësi për ta parë përsëri dritën. Dora është mbështetje. Karrigia e lirë bëhet prani e mungesës. Filxhani që ftohet mbi tryezë bëhet pritje. Fotografia është një copë kohe që ka refuzuar

të zhduket plotësisht.

Kjo thjeshtësi nuk është varfëri shprehjeje, ajo është zgjedhje.

Pas një veprimtarie ku mendimi ka kërkuar shpesh thellësi dhe shtjellim, në këtë përmbledhje autori e kërkon një formë tjetër të thellësisë: atë që gjendet në një gjest të vogël, në një varg të thjeshtë, në një pamje që nuk ka nevojë të shpjegohet gjatë.

Këtu qëndron edhe dimension i shpirtëror i librit.

Jo në predikim, jo në imponim, por në bindjen se njeriu ka nevojë për mirësi, afërsi, mëshirë, falje dhe për ndjenjën se nuk është i vetmuar.

“Një grusht dashuri” e mbart pikërisht këtë ide. Dashuria këtu nuk matet me madhësinë e fjalëve, por me peshën e gjesteve të vogla.

Një dorë.

Një derë e hapur.

Një gotë ujë.

Një vend pranë dikujt.

Një fjalë e thënë në kohën e duhur.

Ndoshta kaq mund t'i japë një njeri një njeriu.

Dhe ndonjëherë, kaq mjafton:

një grusht dashuri.

KUR TË VIJË MËNGJESI

Kur të vijë mëngjesi,
mos më sill asgjë!

Eja siç je,
me sytë ende të përgjumur
dhe flokët pa i rregulluar.

Ulu pranë meje!

Kafeja
do të ftohet duke folur ngadalë,
dielli
do të hyjë pa trokitur nëpër dritare.

Dhe ndoshta do ta kuptojmë
se mëngjesi ishte i bukur
vetëm pse ishim aty ne.

MOS SHKO PA MË PARË

Mos shko pa më parë!
Dua të më shohësh në sy.

Ndoshta nuk do të kemi
asgjë të madhe për të thënë.

Mund të rrimë pak pranë njëri-tjetrit,
si dy dritare në të njëjtën dritë.

Pastaj shko.

Do të më mbetet ai çast i vogël
kur ishim pranë
dhe nuk na duhej asnjë fjalë.

KAFEJA

Kafeja ishte e hidhur,
por ti ishe përballë.

Folëm pak, qeshëm shumë.

Kur u ngritëm,
kafeja kishte mbaruar,
por ëmbëlsia
kishte mbetur brenda meje.

DASHURIA E QETË

Mos m'i premtu yjet!
Ulu pranë meje kur jam i lodhur.

Mos ma sill gjithë botën.
Ma sill një gotë ujë të freskët.

Dashuritë më të mëdha
shpesh janë në gjërat më të vogla.

SHUMË RRUGË TË BUKURA

Kam parë
shumë rrugë të bukura,
por asnjëra
nuk më është dukur më e bukur
se ajo ku më prisje.

NËSE MË DO

Nuk më solle lule, as dhurata.

Erdhe një mbrëmje
kur isha lodhur nga dita.

U ule pranë meje
dhe nuk pyete shumë.
Më dëgjove
derisa fjalët m'u shterën.

Pastaj ma preke dorën.

Atë çast e kuptova
se dashuria nganjëherë nuk thotë asgjë,
vetëm qëndron pranë.

TË DUA

Nuk ta thashë me zë të lartë.

Ta lashë kafen pranë dritares.

Ta mbulova supin kur të zuri gjumi.

Një mbrëmje më kape dorën
dhe buzëqeshe.

Atëherë e kuptova
se e kishe dëgjuar prej kohësh
atë - "Të dua."

MOS E MAT DASHURINË

Ti më dhe një lule, unë të solla një libër.

Pastaj erdhën ditë
kur nuk kishim asgjë për të dhënë.

Vetëm rrinim pranë.
E ndanim bukën,
heshtjen dhe përditshmërinë.

Vitet kaluan.
Lulet u thanë.
Shumëçka u harrua,
por
ajo që ishte mes nesh
nuk kishte pasur nevojë për peshore.

DY FILXHANË

Vura dy filxhanë mbi tryezë.
Njërin për mua, tjetrin për ty.

Kafeja u ftoh.

Ti nuk erdhe.

Atë mbrëmje e kuptova
se edhe pritja e ka shijen e saj:
pak të hidhur,
pak dashuri.

MË PRIT

Më prit te dera e vjetër.
Aty ku dikur kthehesha me vrap.

Ndoshta
do të vij me hapa më të ngadalshëm
dhe me pak dimër në flokë.

Mos thuaj asgjë.

Mjafton ta shoh
dritën ndezur në dritaren tënde,
që ta di,
se ende kam ku të kthehem.

DHURATA

Erdhe në ditëlindjen time me duart thatë.
U ule pranë meje dhe qëndrove gjatë.

Folëm për vitet,
për njerëzit që nuk janë,
për ëndrrat që ende na presin.

Kur u ngrite, më përqafove.

Mbi tryezë nuk mbeti asnjë dhuratë,
por në zemër më mbeti
prania jote.

NUK MË DUHET SHUMË

Nuk më duhet shtëpi e madhe.
Më duhet dikush brenda saj.

Nuk më duhet tryezë e pasur.
Më duhet dikush përballë.

Gjërat e mbushin shtëpinë.
Njerëzit e bëjnë shtëpi.

KOHA QË E DHUROJMË

U ula pranë teje vetëm për pak.

Ora e murit ecte,
por ne nuk e shikonim.

Ti flisje, unë të dëgjoja.

Jashtë kalonin njerëzit,
makinat,
dita.

Kur u ngrita të shkoja,
e kuptova se nuk të kisha sjellë asgjë,
pos kohës sime.

Dhe ti - buzëqeshe.

NËSE NJË DITË

Nëse një ditë
nuk do të mund të ecësh shpejt.
Unë do të ec me ty ngadalë.

Nëse nuk mund të flasësh,
do të rri me ty në heshtje.

Dashuria
nuk është t'i kërkosh tjetrit
të ecë me ritmin tënd.
Është - të dish
ta përshtatësh
hapin
për
të.

VETËM NJË FJALË

Nuk të kërkova bukë,
as strehë, as ta mbaje barrën time.

U ula pranë teje
me heshtjen që më rëndonte.

Ti nuk pyete shumë,
vetëm më pe në sy dhe ma the një fjalë.

Jashtë vazhdonte shiu,
por brenda meje ndriçoi pak dritë.

Kur u ngrita,
duart i kisha ende të zbrazëta,
por zemrën jo.

Nganjëherë
njeriun e mban vetëm një fjalë.

MOS E PYET

Mos e pyet njeriun pse hesht.

Ndoshta brenda tij ka aq shumë zëra,
sa mezi arrin ta ruajë buzëqeshjen.

Ulu pranë tij.

Nganjëherë prania e qetë
thotë më shumë se çdo pyetje.

GJYSMA E PORTOKALLIT

Në tren, një grua e moshuar
e qëroi portokallin ngadalë.

Gjysmën
ia dha të panjohurit përballë saj.

Nuk e pyeti nga vinte,
as ku do të zbriste.

Ai e mori dhe buzëqeshi.

Për disa çaste,
vagioni mbajti aromën e portokallit
dhe ngrohtësinë e dy njerëzve.

MË THIRR

Kur nata të jetë e gjatë
dhe gjumi të mos vijë,
emri im është ende aty.

Më mjafton
një zë nga ana tjetër e telefonit,
një “alo” e thënë ngadalë.

Ndoshta nuk do t'i gjejmë fjalët e duhura.

Ndonjëherë nuk na duhen fjalët.
Na duhen vetëm fjalët që ngrohin.

KUR NUK KE ASGJË

Erdhi duarbosh dhe u ul pranë meje.
Nuk solli bukë,
as ndonjë fjalë të madhe.

Më dëgjoji gjatë,
pa ma ndërprerë heshtjen.

Kur u ngrit të shkonte,
ma vuri dorën mbi sup dhe buzëqeshi.

Nuk më kishte dhënë asgjë
që mbahet në dorë,
ma dha
atë mbrëmje ku nuk u ndjeva vetëm.

MOS U TURPËRO TË QASH

E mbajti gjatë shiun brenda vetes.
Buzëqeshte,
fliste,
ecte mes njerëzve.

Një mbrëmje
i shpëtuan dy lot dhe i ranë mbi duar.

Nuk u shemb asgjë.
Vetëm zemra u bë pak më e lehtë.
U bë si qielli pasi kalon shiu.

DËGJOMË

Nuk erdha të më japësh përgjigje.
As të ma tregosh rrugën.

Kisha vetëm
disa fjalë të lodhura brenda meje.

Ti u ule dhe më dëgjove.

Kur mbarova,
asgjë nuk kishte ndryshuar përreth,
por brenda meje
kishte më shumë qetësi.

PLAGA

Ti buzëqeshje si çdo herë.

Vetëm kur heshtëm,
sytë e tu
thanë diçka tjetër.

U ula më afër.

Nuk të pyeta ku të dhembte.

Ndenjëm ashtu
derisa mbrëmja na mbuloi të dyve.

Disa plagë
kanë nevojë vetëm për praninë.

MOS U BËJ GUR

E pashë duke qarë në fund të rrugës.
Kalova pranë tij, pastaj u ndala.

Nuk e njihja.

Iu ula afër pa e pyetur asgjë.

Pas pak
më pa në sy.

Nuk i thashë as një fjalë.
Vetëm qëndrova aty,
derisa
lotët
iu
qetësuan.

MOS E MBAJ

E mbajta gjatë dhimbjen brenda.

Askush nuk e shihte.

Ajo vinte me mua kudo që shkoja.

Një mbrëmje ta tregova ty.

Ti nuk the asgjë.

Vetëm

ma more dorën.

Dhimbja nuk u zhduk.

Por atë natë u bë më e lehtë .

TELEFONOJE

Më erdhe ndër mend pa ndonjë arsye.

E pashë emrin tënd në telefon
dhe mbeta një çast.

Pastaj të thirra.
- Alo!

Vetëm kaq,
dhe largësia mes nesh
u bë më e vogël.

Nganjëherë
malli e di para nesh
ku duhet të trokasë.

MOS E THYEJ

E mbante në duar si një gotë të hollë.
Një fjalë e rëndë
mjaftonte
ta kriste.

Ai heshti.

Pastaj i buzëqeshi dhe ia zgjati dorën.

Mes tyre
mbeti diçka e brishtë,
por e plotë.

Nganjëherë zemra nuk kërkon shumë -
vetëm
pak
kujdes.

KUR ZEMËROHESH

Fjala më erdhi deri te buzët.
Ishte e rëndë.

E pashë në sytë e tu vendin
ku do të binte dhe heshta.

Mbrëmja kaloi,
dhe zemërimi gjithashtu.

Të nesërmen e pimë kafën bashkë.

Në filxhan nuk kishte mbetur
asgjë nga stuhia e djeshme.
Nuk rëndoi në zemrën tënde
fjala që nuk e thashë.

KËRKO FALJE

Erdha te dera jote me fjalë të rënda
që ma kishin zënë rrugën.

Ti ma hape derën.

Për një çast nuk ditëm ç'të thoshim.

- Më fal, - thashë.

Asgjë nuk u kthye siç kishte qenë,
por mes nesh
u hap një shteg
ku mund të ecnim përsëri.
Dhe dera - mbeti e hapur.

FALJA

Të fala.
Dhe kjo më përvëloi.

Të fala
që të mos e mbaja dhimbjen tënde
brenda meje.

Ti vazhdove rrugën tënde.
Edhe unë,
më në fund e vazhdova timen.

NJË PËRQAFIM

U takuam pas shumë vitesh.

Në fillim
nuk ditëm ç'të thoshim.

Koha kishte vënë pak thinja në flokë
dhe shumë kujtime mes nesh.

Pastaj u përqaftuam.

Për një çast
vitet u tërhoqën mënjanë
dhe brenda atij përqaftimi
ishim përsëri ata që kishim qenë.

NËNA

U rrita dhe mendova se u bëra i fortë.

Pastaj një ditë
më mori malli për nënën
dhe kuptova se brenda çdo burri
mbetet një fëmijë
që kërkon të kthehet në shtëpi.

DUART E NËNËS

Duart e nënës plaken para fytyrës,
sepse gjithë jetën
kanë larë,
gatuar,
përkëdhelur,
mbajtur.

Kur t'i puthësh, mos i shiko rrudhat.
Aty është e shkruar fëmijëria jote.

BABAI

Babai fliste pak.

Duart e tij flisnin më shumë
me bukën mbi tryezë,
me derën e rregulluar,
me këpucët e mia pranë pragut.

Vetëm kur u rrita,
e kuptova
sa shumë më kishte thënë pa fjalë.

DORA

Kur isha i vogël,
ma mbaje dorën të mos rrëzohesha.

Sot ecën ngadalë.

Ma jep dorën, baba!

Nuk është kthim borxhi.
Është dashuria që ndërroi trajta.

MOTRA

Motra është:
pak nënë,
pak shoqe,
pak fëmijëri.

Mund të kalojnë vite pa u parë.
Por kur takohemi,
shtëpia e dikurshme
e hap përsëri derën.

VËLLAI

Mund të grindemi,
të heshtim,
të largohemi.

Por nëse dikush të prek ty,
diçka
brenda meje zgjohet menjëherë.

Gjaku ka kujtesë
që zemërimi nuk e fshin.

GJYSHI

Gjyshi ecte ngadalë,
por tregimet e tij vraponin larg
Na çonin
në kohët që s'i kishim parë.

Sot ai nuk është.
Sa herë e tregoj historinë e tij,
gjyshi ecën edhe pak me mua.

GJYSHJA

Në xhepin e gjyshes
gjithmonë kishte diçka:
një karamele,
një arrë,
një pare.

Më vonë e kuptova
se dhurata e vërtetë nuk ishte në xhep -
ishte dashuria e saj për ne.

PREHRI I GJYSHES

Kur lodhesha nga rrugët,
kthehesha te prehri i gjyshes.
Aty dita bëhej më e qetë
dhe dhimbja e humbte zërin.

Duart e saj mbanin erë buke,
kurse sytë - dritën e kandilit.
M'i ledhatonte flokët
pa më pyetur pse heshtja.

Tani prehri i saj më mungon.
Por sa herë lodhem nga jeta,
i mbyll sytë
dhe kthehem fëmijë
nën dorën e saj.

BUKA

Nëna e ndau bukën në copa të barabarta.
Për vete e la më të voglën.

Askush nuk e vuri re.

Vite më vonë,
kur u mbledhëm përsëri rreth asaj tryeze,
buka e kishte të njëjtën erë,
por vendi i saj ishte i zbrazët.

Atëherë e kuptuam
sa shumë dashuri kishim ngrënë
pa e ditur.

NJË COPË BUKË

E ndamë bukën në dy pjesë.
Gjysma ishte imja, gjysma jotja.

Kur e hëngrëm bashkë,
nuk kishte më -
e imja, e jotja.

Kishte vetëm një tryezë dhe dy njerëz.

MOS E KËRKO LARG

Eca gjatë nëpër rrugë të largëta,
në qytete
ku askush nuk më njihte.

Në një mbrëmje u ktheva i lodhur.

Nëna e kishte lënë dritën ndezur,
bukën mbi tryezë dhe derën pa çelës.

U ula në heshtje.

Ajo që e kërkoja larg
më kishte pritur gjithë kohën
në shtëpi.

MOS MA MBYLL DERËN

Erdha vonë,
kur nata kishte rënë kudo.

Nuk solla asgjë,
veç lodhjes dhe pak heshtje.

Ti
e hape derën dhe u tërhoqe mënjanë.

Nuk më pyete ku kisha qenë.

Hyra.

Atëherë e kuptova
sa ngrohtë është kur dikush
ta lë derën hapur.

DERA E HAPUR

Ka shtëpi të mëdha ku mezi merr frymë.
Ka dhoma të vogla ku zemra zgjerohet.

Madhësinë e shtëpisë e mat metri,
ngrohtësinë
e mat mënyra se si të hapet dera.

SHTËPIA E VJETËR

Muret janë çarë.
Dera mezi hapet.

Por kur hyj,
ende i dëgjoj të qeshurat tona.

Shtëpitë e vjetra
nuk mbahen vetëm me gurë -
i mban kujtesa.

KTHEHU

Shtëpia ishte aty, në fund të rrugës.

Dera i ishte plakur.
Muret e mbanin erën e viteve.

Hyra ngadalë.

Në një qoshe
e gjeta lodrën time të mbuluar
me pluhur.

E mora në dorë.

Për një çast
nuk isha kthyer vetëm në shtëpi -
isha kthyer
te fëmija që kisha qenë.

FËMIJËT TANË

Dikur i mbanim për dore.

Hapat e tyre të vegjël
nxitonin pas nesh.

Sot ecin përpara,
me rrugët dhe ëndrrat e tyre.

Ne mbetemi pak pas
dhe i shohim
sa
largohen.

Vetëm dora
ende e kujton atë dorën e vockël
që dikur
mbahej
pas
saj.

QENI TE PRAGU

Çdo mbrëmje më priste te pragu.

Nuk kishte orë.

Nuk dinte kalendar.

E dinte vetëm

se

do të kthehesha.

SHOKU

Erdhi pa më lajmëruar
dhe trokiti në derë.

Nuk më pyeti pse kisha heshtur kaq gjatë.

Solli pije të freskët.
E mbusha në dy gota.
U ulëm pranë njëri-tjetrit.
Ai foli për gjëra të vogla.

Kur u ngrit të shkonte,
shtëpia ishte po ajo,
por vetmia
kishte dalë bashkë me të nga dera.

MIKU I VJETËR

Me mikun e vjetër
nuk ke nevojë ta tregosh historinë
nga fillimi.

Ai i njeh kapitujt e tu.

Madje edhe ata që do të doje
t'i kishe grisur.

Dhe përsëri - ulet pranë teje.

FQINJI

E përshëndesnim çdo mëngjes.

- Mirëmëngjes!

- Mirëmëngjes!

Asgjë më shumë.

Një ditë dera e tij mbeti e mbyllur.

Atëherë e kuptova
sa shumë prani
kishte pasur në atë përshëndetje
të vogël.

DY TË PANJOHUR

U ulën
dy të panjohur në të njëjtën tavolinë.

Njëri tha:
- Ditë e bukur.

Tjetri buzëqeshi.

Bota nuk ndryshoi.

Por për një çast vetmia e të dyve
u përgjysmua.

MOS PRIT DUARTROKITJE

E mbolli një pemë pranë rrugës
dhe shkoi.

Askush nuk e pa.
Askush nuk e pyeti për emrin.

Kaluan vite.

Një udhëtar i lodhur u ul nën hijen e saj.
Një fëmijë e këputi një kokërr.
Dy zogj e ngritën folenë.

Njeriu që e mbolli nuk ishte aty.

Pema po.

FËMIJA

Fëmija ma dha një lule të këputur.
- Merre! - më tha.

E mora.

Ai shkoi duke qeshur,
ndërsa unë
mbeta me gjithë pranverën në dorë.

PLAKU DHE FËMIJA

Plaku e shikonte fëmijën
që vraponte pas fluturës.

Buzëqeshi.

Fëmija vraponte drejt së ardhmes,
plaku drejt kujtimeve.

Vetëm flutura
nuk e dinte çfarë ishte koha.

NJË FËMIJË QESHI

Në autobus një fëmijë qeshi pa arsye.

Pas pak qeshi e ëma e tij.

Pastaj një plak.

Pastaj edhe unë.

Ja si një fëmijë,

pa ditur asgjë për botën,

e bëri botën pak më të bukur.

NJË LULE

Në çarjen e murit kishte mbirë një lule.

Askush nuk e kishte mbjellë.

Askush nuk e ujiste.

Çdo mëngjes ajo hapej nga dielli
dhe tundej lehtë kur kalonte era.

Njerëzit nxitonin pa e vënë re.

Vetëm një fëmijë u ndal pranë saj
dhe i buzëqeshi.

Atë ditë
lulja kishte një mik.

NJERIU QË BUZËQESHI

Kaloi pranë meje një i panjohur.

Më buzëqeshi.

Nuk e di kush ishte,
nga vinte,
ku shkonte,
por për disa hapa
bota m'u duk vend më i mirë.

Ja sa pak
mund të duhet
për ta ndryshuar ditën e dikujt.

NJERIU I MIRË

E takova në rrugë
duke mbajtur një trastë të rëndë.

U ndal
t'ia hapte derën një plaku.

Pastaj
e ngriti nga toka lodrën e një fëmije.

Askush nuk e njihte.

Askush nuk e falënderoi.

Ai e vazhdoi rrugën
sikur të mos kishte bërë asgjë të veçantë.

Pas tij mbeti vetëm pak mirësi,
por dita nuk kaloi kot.

KUR TË PLAKEM

Kur të plakem,
mos më sill shumë gjëra.
Eja vetëm ti.

Ulu pranë meje
dhe më trego çfarë bëjnë njerëzit,
si lulëzojnë pemët,
sa dashuri ka...

Dua ta di
se bota
a vazhdon ende të jetë e bukur.

KUR PLAKET NJERIU

Kur plaket njeriu,
hapat bëhen më të ngadalshëm,
por kujtimet ecin më shpejt.

Një këngë e vjetër e kthen te rinia.
Një erë buke, te shtëpia e fëmijërisë.

Ulet pranë dritares.
I sheh fëmijët duke vrapuar në rrugë.

Buzëqesh.

Diku brenda
tij
ende vrapon ai fëmijë.

DY PLEQ

Dy pleq ecnin ngadalë.

Ai e mbante bastunin.
Ajo krahun e tij.

Nuk flisnin.

Kishin folur një jetë të tërë.

Tani
dashuria
nuk kishte më nevojë për fjalë.

RRUDHAT

Mos i fshih rrudhat.

Disa prej tyre janë buzëqeshje
që kanë mbetur mbi fytyrë
si shkrime.

Disa janë dhimbje që i ke kaluar.

Fytyra e plakur është ditari
që koha
e shkruan pa laps.

PEMA

E mbollëm të vogël pranë shtëpisë.

Unë rritesha
Ajo gjithashtu.

Vitet kaluan.

Degët iu mbushën me zogj e hije.
Flokët e mi me pak borë.

Sot
ulem nën të dhe e prek trungun.
Të dy kemi rrudha.

Ende e njohim njëri-tjetrin.

FOTOGRAFIA

Në fotografi jemi të gjithë të rinj.

Askush nuk ka vdekur.

Askush nuk është plakur.

Sa e çuditshme fotografia:

e ndal kohën,

por nuk mund ta ndalë mallin.

LETRA

E gjeta një letër të vjetër.

Shkrimi ishte zbehur.

Fjalët jo.

Sa çudi:

dora që e shkroi mund të mos jetë më,

por dashuria

ende e lexon.

KËNGA E VJETËR

E dëgjova një këngë të vjetër.

Për tri minuta
u ktheva tridhjetë vjet pas.

Ja çfarë bën kujtesa:
trupi mbetet këtu,
ndërsa zemra -
i di rrugët
që koha i ka mbyllur.

KËPUCËT E VJETRA

I gjeta pranë derës së vjetër.

Ishin pluhurosur,
me lidhëset ende siç i kishe lënë.

I mora në duar.

Sa rrugë kishin ecur?
Sa herë ishin kthyer në këtë shtëpi?

Ti nuk ishe më,
por këpucët prisnin pranë pragut,
sikur një mbrëmjeje
doje të ktheheshe.

KARRIGIA E ZBRAZUR

Në tryezë
ka mbetur një karrige e zbrazët.

Askush nuk ulet aty.

Por sa herë hamë,
dikush e shikon fshehurazi.

Njerëzit largohen,
por dashuria
nuk di të ngrihet nga vendi i tyre.

DRITARJA

Çdo mëngjes e hap të njëjtën dritare.

Qielli nuk është kurrë i njëjti.

Atëherë mendoj:
pse duhet të mbetem i njëjti unë?

Dhe
ia jap zemrës edhe një mundësi.

KUR HUMB

U ktheva rrugëve ku kisha kaluar.

Pastaj u ula
dhe ti më erdhe ndër mend.

Atëherë e kuptova
se nuk të kisha humbur ty.

Ti kishe mbetur diku brenda meje,
si kujtim
që priste të zgjohej.

KUR TË MË TAKOSH

Kur të më takosh,
mos më pyet si më ka shkuar jeta.
Por shikoji sytë e mi.
Aty kanë mbetur rrugët që i kam kaluar
dhe njerëzit që i kam dashur.

Ulu pranë meje.

Ndoshta heshtja
do të na tregojë atë
që fjalët e kanë harruar.

MOS MË MBAJ MEND

Mos më mbaj mend për fjalët që i thashë.

Ato i mori koha
si gjethet
në fund të vjeshtës.

Nëse një ditë ta kam hapur derën,
ta kam zgjatur dorën
ose të kam ndenjur pranë
kur të tjerët shkuan -
më kujto aty.

Njeriu mbetet më gjatë në zemrën e tjetrit
me ato që i ka bërë,
jo me ato që i ka thënë.

KUR TË VDES

Kur të vdes,
mos numëroni sa libra lashë,
sa fjalë shkrova,
sa njerëz më njohën.

Nëse vetëm një njeri thotë:
- Kur isha pranë tij, ndihesha njeri -
atëherë kam lënë mjaft.

LËR DIÇKA

Një ditë
dera do të mbetet pa u hapur.
Kolltuku pa trupin tënd.

Emri do të thuhet gjithnjë e më rrallë.
Fotografitë do të zverdhen.

Por diku
mund të jetë një njeri
që ende buzëqesh nga mirësia jote.

Ndoshta
kjo është ajo që nuk e merr koha -
pak dashuri e lënë te tjetri.

MBRËMJA

Mbrëmja erdhi
dhe i mbylli ngadalë dyert e ditës.

Disa gjëra nuk i mbarova.
Disa fjalë nuk i thashë.
Por jam këtu.

Edhe kjo
është arsye për ta falënderuar jetën.

PARA SE TË FLEMË

Nata u ul mbi çatitë e shtëpive.
Dritat një nga një filluan të fikeshin.

Mendova për një fjalë
që mund ta kisha thënë më butë,
për një njeri që e priste një përqafim.

Pastaj i mbylla sytë.

Në heshtjen e natës
zemra
ende kërkonte të linte diçka të mirë
deri në mëngjes.

SHIU

Të gjithë u fshehën nën strehë.

Vetëm një fëmijë mbeti në shi.

I hapi duart,
e ngriti fytyrën nga qielli dhe qeshi.

Uji i rridhte nëpër faqe,
ndërsa ai kërcente mes pellgjeve,
sikur qielli të kishte zbritur
të luante me të.

MËNGJESI PAS LOTËVE

Mbrëmë qava.

Sot dielli lindi përsëri.

Askush nuk e pyeti natën
sa e rëndë kishte qenë.

Drita vetëm erdhi.

Zbardhi pa ditur gjë për lotët e mi.

MOS E HUMB DITËN

Kafeja nxirrte avull.

Dielli e prekte dritaren.

Në oborr dikush qeshte.

Një zog kërkonte thërrime.

Unë prisja
të ndodhte diçka e madhe.
Pastaj i ngrita sytë.

Kafeja ishte ende e ngrohtë,
dielli ende në dritare,
e qeshura vinte nga oborri.

Dita nuk kishte pritur të bëhej e bukur.
Ishte e bukur
që kur kishte ardhur.

NJË DITË E ZAKONSHME

Sot nuk ndodhi asgjë e madhe.

E piva kafën,
E përshëndeta fqinjin.
E dëgjova një zog.
Pastaj u ktheva në shtëpi.

Në mbrëmje e kuptova
se jeta
kishte kaluar gjithë ditën pranë meje
dhe unë
pothuajse nuk e kisha vënë re.

NJË QIRI

Mbrëmja kishte hyrë në shtëpi pa zë.

U fikën dritat.

Dhoma u mbush me errësirë.

Ndeza një qiri.

Flaka e vogël nuk e largoi natën.

Mjaftoi

t'i shihnim fytyrat e njëri-tjetrit.

Dhe, me pak dritë,

errësira nuk na dukej aq e madhe.

DIELLI NUK PYET

Në mëngjes
dielli hyri në oborr
pa pyetur kush banonte aty.

Ra mbi çatinë e vjetër,
mbi pemën,
mbi dritaren e fqinjit
dhe mbi duart e mia.

Për një çast
gjithçka e kishte të njëjtën dritë.
Askush nuk mbeti jashtë saj.

NJË COPË QIELL

Mes dy ndërtesave dukej pak qiell.

U ndala dhe e ngrita kokën.

Një re kaloi ngadalë.

Një zog
e preu kaltërsinë dhe humbi larg.

Rruga vazhdonte me zhurmën e saj.

Por për një çast
ajo copë e vogël qielli
më hapi brenda një hapësirë
pa mure.

NESËR

E lamë për nesër atë që duhej thënë sot.
Mendonim se kishim kohë.

Mbi tryezë mbetën dy filxhanë,
njëri i paprekur.

Në mëngjes dielli hyri si çdo ditë,
por vendi përballë
kishte mbetur i zbrazët.

Atëherë e kuptova
se çdo fjalë nuk e pret të nesërmen.

MOS E HARRO VETEN

Gjithë ditën ua hapa dyert të tjerëve.

Ua mbusha gotat,
ua dëgjova hallet,
u dhashë nga pak prej vetes.

Në mbrëmje mbeta i vetëm.

Vura re
se edhe duart e mia ishin të lodhura.

I vura mbi zemër
dhe për herë të parë,
atë ditë,
u kujdesa edhe për mua.

NJERIU NË PASQYRË

Në mëngjes u ndala para pasqyrës.

Fytyra ishte e imja,
por sytë
sikur më pyesninin për diçka.

M'u kujtua
një fjalë që dje e thashë pa e matur,
në vend të një dore
që mund ta kisha zgjatur.

E preka pasqyrën.

Njeriu përballë
nuk kërkonte të ishte i përsosur -
pyeste
pse sot
nuk qe më i mirë se dje.

MOS U KRAHASO

Në të njëjtin kopsht rritej një trëndafil.

Pranë tij një pemë
dhe mbi degë
një zog.

As lulja nuk kërkoi të fluturonte.
As zogu të lulëzonte.

Secili e kishte qiellin e vet.

Vetëm njeriu rrinte para pasqyrës
dhe e pyeste veten
pse nuk ishte dikush tjetër -
më madhështor.

KRYESORJA - TË JESH MIRË

Nata i shkund yjet mbi çatinë time.
Hëna endet e vetme nëpër qiell.

Unë nuk kërkoj të më kujtosh,
veç dua që mëngjesi të të gjejë mirë.

Nëse të dhemb ndonjë plagë e vjetër,
le ta marrë era përtej maleve;
nëse vetmia të ulet pranë dritares,
le të të bëhet këngë e jo trishtim.

Rrugët tona
mund të humbin nëpër mjegull,
vitet mund t'i zbehin gjurmët tona,
por zemra ime
e ruan një lutje të heshtur:
"Për ty
të ketë gjithmonë dritë -
kryesorja,
kudo që të jesh, të jesh mirë."

PASTHËNIE

Kur mbyllet një libër me poezi, fjalët mbeten pas, por përjetimi i tyre mund të vazhdojë. Pikërisht aty fillon jeta tjetër e poezisë: jo më në dorën e autorit, por në kujtesën e lexuesit.

“Një grusht dashuri” lindi nga një afrim i tillë me fjalën. Jo me fjalën e madhe, të zhurmshme e urdhëruese, por me atë që vjen qetë, ulet pranë njeriut dhe ndonjëherë arrin atje ku nuk arrijnë shpjegimet.

Në këto poezi kalojnë njerëz të zakonshëm dhe çaste të zakonshme. Nëna, babai, fëmija, miku, dy pleq, një i panjohur. Dera që hapet, karriga që mbetet e zbrazët, fotografia që e ruan kohën, filxhani që ftohet duke e pritur dikë. Janë gjëra të vogla, por pikërisht prej tyre ndërtohet pjesa më e madhe e jetës sonë.

Për autorin, kjo përmbledhje e shënon edhe një lëvizje të brendshme në krijimtari. Fjala, pas shumë kërkimesh letrare e filozofike, këtu kthehet te njeriu. Nuk kërkon ta udhëheqë me çdo kusht, as t'i tregojë se çfarë duhet të mendojë, kërkon t'i afrohet, sepse ndonjëherë vargu nuk ka nevojë të japë përgjigje, mjafton ta zgjojë kujtimin, apo ta sjellë para syve fytyrën e nënës, duart e babait, mikun e vjetër, derën ku kemi trokitur dikur, njeriun të cilit nuk ia thamë në kohë fjalën që duhej.

Në këtë kuptim, poezia bëhet afërsi.

Ajo nuk e zëvendëson njeriun, por mund ta çojë te njeriu. Nuk e kthen atë që ka shkuar, por mund ta sjellë për një çast pranë nesh. Nuk e ndal kohën, por mund ta shpëtojë prej saj kujtimin, buzëqeshjen, përqafimin.

Në fund, ndoshta edhe vetë libri kërkon shumë pak nga lexuesi: të mos nxitojë. Të ndalet te ndonjë varg. Ta kujtojë dikë. Ta telefonojë mikun. Të hapë derë. Ta thotë fjalën e mirë sot, jo nesër.

Nëse pas faqes së fundit lexuesi e ndien dëshirën të jetë pak më pranë një njeriu, atëherë këto poezi e kanë gjetur vendin e tyre, sepse njeriu mund të kalojë një jetë duke kërkuar shumëçka dhe, në fund, ta kuptojë se ajo që i ka mbetur më gjatë nuk ka qenë madhështia e gjërave, por ngrohtësia e njerëzve.

Ndoshta kjo është edhe fjala e fundit e këtij libri:

të lëmë te njëri-tjetri pak mirësi,

pak kujtim,

pak dritë

dhe një grusht dashuri.

ANALIZË LETRARE REDAKSIONALE

“Një gusht dashuri”

Përmbledhja poetike “Një gusht dashuri” nuk mund të lexohet e shkëputur nga udha krijuese e Berzat Sadikit. Pas saj qëndron një autor me marrëdhënie të gjatë me fjalën, poezinë, arsimin, mendimin dhe kërkimin shpirtëror. Prandaj ky libër nuk e shënon vetëm një përmbledhje të re poezish, por edhe një ndryshim të ndjeshëm të frymës së tij letrare.

Sadiki këtu sikur kthehet te fjala për ta zhveshur atë nga pesha e tepërt e shpjegimit. Pas kërkimit të gjatë të kuptimeve, ai e gjen njeriun te gjërat më të vogla: te dora, buka, dera, filxhani, fotografia, shtëpia, shiu, heshtja. Mendimi nuk është zhdukur, por është futur më thellë në varg.

Në këtë kuptim, “Një gusht dashuri” e përfaqëson një lëvizje nga poezia që dëshiron të thotë, drejt poezisë që dëshiron të prekë.

Autori nuk e braktis prirjen e tij refleksive, përkundrazi, ajo mbetet në bërthamë të librit, por e ndryshon formën. Filozofikja nuk paraqitet më domosdoshmërisht si pohim, ajo mund të gjendet në një baba që dikur ia mbante dorën e fëmijës dhe tani pret dorën e tij; në dy pleq që ecin pa pasur nevojë të

flasin; në fotografi ku të gjithë kanë mbetur të rinj; te karrigia e zbrazët që vazhdon ta ruajë praninë e atij që mungon.

Kështu mendimi bëhet pamje,
pamja bëhet ndjenjë,
ndjenja bëhet kuptim
dhe kuptimi kthehet te njeriu.

Pikërisht këtu shfaqet fryma e re letrare e Berzat Sadikit. Në krijimtarinë e tij fjala ka qenë e lidhur gjatë me kërkimin: me njeriun, shoqërinë, dijen, qenien, të mirën dhe kuptimin e ekzistencës. Në këtë përmbledhje, megjithatë, kërkimi sikur kthehet nga jashtë brenda. Pyetja nuk është më vetëm çfarë është njeriu, por çfarë mbetet mes dy njerëzve.

Përgjigjja e librit nuk jepet si tezë.

Mund të jetë dorë.

Mund të jetë pritje.

Mund të jetë heshtje.

Mund të jetë fjalë.

Mund të jetë një grusht dashuri.

Këtu qëndron edhe dimension i shpirtëror i përmbledhjes. Ai nuk ndërtohet nëpërmes predikimit, por nëpërmes etikës së afërsisë. Mirësia, falja, dhembshuria, kujtesa dhe dashuria nuk trajtohen vetëm si nocione,

ato e marrin trupin e tyre poetik në jetën e zakonshme. Sadiki duket sikur ka arritur në një pikë ku nuk dëshiron më ta bindë lexuesin për vlerën e mirësisë. Dëshiron t'ia tregojë skenën ku mirësia ndodh, dhe pastaj vetë të tërhiqet.

Kjo është një kthesë e rëndësishme, sepse poezia fiton atëherë kur autori i beson edhe heshtjes së vet.

Nga kjo pikëpamje, motivet e përsëritura të librit - drita, shtëpia, pragu, dora, buka, nëna, babai, fëmija, pleqëria - e krijojnë një hartë shpirtërore të autorit. Ato nuk janë dekor. Janë vendet në hartë ku ai e kërkon njerëzoren.

Edhe koha e përshkon pothuajse gjithë përmbledhjen. Fëmija rritet. Babai plaket. Nëna mbetet në kujtesë. Shtëpia vjetërohet. Fotografia nuk ndryshon. Karrigia zbrazet. Përballë kësaj ikjeje, poeti e vendos dashurinë si një nga mënyrat e pakta me të cilat njeriu mund t'i kundërvihet humbjes, jo pse dashuria mund ta ndalë kohën, por sepse mund ta ruajë diçka prej asaj që koha e merr.

Këtu titulli “Një grusht dashuri” e fiton dimensionin e tij të plotë poetik. “Grushti” nuk shpreh madhësi të madhe; përkundrazi, e shpreh masën njerëzore të vogël, të prekshme, të dhënshme. Dashuria nuk paraqitet si abstraksion, por si diçka që kalon nga një njeri te tjetri nëpërmes veprimit.

Kjo është arsyeja pse objektet dhe gjestet e zakonshme marrin peshë të veçantë në libër. Një gotë ujë, një copë bukë, një telefonatë, një derë e hapur, një dorë mbi sup, një filxhan i dytë mbi tryezë - të gjitha bëhen forma të vogla të dashurisë.

Në këtë mënyrë, titulli e përmbledh poetikën e veprës: njeriu nuk ka gjithmonë mundësi t'ia japë tjetrit botën, por mund t'ia japë diçka nga vetja.

Kjo mund të konsiderohet edhe pika estetike më interesante e përmbledhjes: kalimi nga fjala që udhëzon te fjala që shoqëron dhe nga dashuria që deklarohet te dashuria që vepron.

Poezitë më të realizuara janë ato ku Berzat Sadiki si autor tërhiqet një hap prapa dhe Berzat Sadiki si njeri që mbetet brenda poezisë, ku atëherë

nuk flet autoriteti, flet përvoja,

nuk flet mësuesi, flet njeriu

dhe pikërisht aty poezia ngrohet.

Prandaj “Një grusht dashuri” mund të lexohet si një etapë e re në krijimtarinë e Berzat Sadikit, jo mohim i asaj që ka shkruar më parë, por një qetësim i saj; jo largim nga filozofia, por tretje e filozofisë në përjetim; jo braktisje e shpirtërores, por shndërrim i saj në marrëdhënie njerëzore.

Nëse dikur poeti kërkonte ta vendoste mendimin në varg, këtu kërkon që vargu të hyjë në njeriun.

Dhe në fund mbetet një ide e thjeshtë:
njeriu mund të mos ketë shumë për t'i dhënë njeriut,
por, përderi sa në kraharor të tij ka një zemër që rreh,
ajo mund të japë dashuri, qoftë edhe një grusht
dashuri.

BIOGRAFIA

DHE BIBLIOGRAFIA E AUTORIT

Biografia

Berzat Sadiki u lind në vitin 1962 në Cerovë të Tetovës. Fëmijërinë e kaloi në Uzurmisht, jeton dhe vepron në Tetovë. Është shkrimtar, poet, profesor, përkthyes dhe hulumtues me veprimtari të bujshme letrare dhe përkushtim të vazhdueshëm ndaj artit, kulturës dhe zhvillimit të mendimit krijues.

E kreu Fakultetin filologjik, në drejtimin Gjuhë dhe letërsi maqedonase, ndërsa studimet pasuniversitare i ndoqi në Institutin e gjuhës maqedonase “Krste Misirkov” në Shkup, në drejtimin Maqedonistikë me komunikologji.

Shkruan poezi, prozë, drama, ese dhe vepra filozofike për të rritur dhe për fëmijë. Stili i tij është lirik, refleksiv, filozofik, filozofiko-kuantik, ontologjik dhe edukativ. Krijimtaria e tij karakterizohet nga gjuha e qartë, metafora, simboli, mendimi etik dhe ndërthurja e letërsisë me filozofinë dhe konceptet kuantike. Është themelues i Shtëpisë Botuese “Mirësia” dhe kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve “Pro Litera” në Tetovë.

Bibliografia

- “Sa mirë, sa bukur” – 1996
“Abetare, shoqe e parë” – 1999
“Kur flenë zogjtë” – 2019
“Ku u tret buzëqeshja” – 2020
“Faqet e lagura” – 2020
“Zemër për të gjithë” – 2023
“Lubovna mugra – Agimi i dashurisë” – 2023
“Shite njërin sy” – 2023
“Shtëpi prej shpirti” – 2024
“Bie zilja” – 2025
“Eja krahëhapur” – 2025
“99 letra për Nuranën” – 2025
“Çelësi i Lirisë” – 2025
- “Rruga e dashurisë” – 2026
“Foleja e tregimeve” – 2026

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Hyrje	7
Kur të vijë mëngjesi	11
Mos shko pa më parë	12
Kafeja	13
Dashuria e qetë	14
Shumë rrugë të bukura	15
Nëse më do	16
Të dua	17
Mos e mat dashurinë	18
Dy filxhanë	19
Më prit	20
Dhurata	21
Nuk më duhet shumë	22
Koha që e dhurojmë	23
Nëse një ditë	24
Vetëm një fjalë	25
Mos e pyet	26
Gjysma e portokallit	27
Më thirr	28
Kur nuk ke asgjë	29
Mos u turpëro të qash	30
Dëgjomë	31
Plaga	32
Mos u bëj gur	33
Mos e mbaj	34

Telefonoje	35
Mos e thyej	36
Kur zemërohesh	37
Kërko falje	38
Falja	39
Një përqafim	40
Nëna	41
Duart e nënës	42
Babai	43
Dora	44
Motra	45
Vëllai	46
Gjyshi	47
Gjyshja	48
Prehri i gjyshes	49
Buka	50
Një copë bukë	51
Mos e kërko larg	52
Mos ma mbyll derën	53
Dera e hapur	54
Shtëpia e vjetër	55
Kthehu	56
Fëmijët tanë	57
Qeni te pragu	58
Shoku	59
Miku i vjetër	60
Fqinji	61
Dy të panjohur	62
Mos prit duartrokitje	63

Fëmija	64
Plaku dhe fëmija	65
Një fëmijë qeshi	66
Një lule	67
Njeriu që buzëqeshi	68
Njeriu i mirë	69
Kur të plakem	70
Kur plaket njeriu	71
Dy pleq	72
Rrudhat	73
Pema	74
Fotografia	75
Letra	76
Kënga e vjetër	77
Këpucët e vjetra	78
Karrigia e zbrazur	79
Dritarja	80
Kur humb	81
Kur të më takosh	82
Mos më mbaj mend	83
Kur të vdes	84
Lër diçka	85
Mbrëmja	86
Para se të flemë	87
Shiu	88
Mëngjesi pas lotëve	89
Mos e humb ditën	90
Një ditë e zakonshme	91
Një qiri	92

Dielli nuk pyet	93
Një copë qiell	94
Nesër	95
Mos e harro veten	96
Njeriu në pasqyrë	97
Mos u krahaso	98
Kryesorja - të jesh mirë	99
Pasthënie	100
Analizë dhe kritikë letrare	102
Biografia dhe bibliografia e autorit	107

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497.7)-1

SADIKI, Berzat

Një grusht dashuri : poezi / Berzat Sadiki. -
Tetovë : Pro litera,
2026. - 108, [4] стр. ; 21 см

Biografia dhe bibliografia e autorit: стр. 107

ISBN 978-608-67552-2-5

COBISS.MK-ID 69563653